



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:196192

Datë: 11.12.2024

Numri i dokumentit: 06581058

C.nr.610/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike të paditësit M.Q nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i tij i autorizuar D.M avokat nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1.431.40 €, jashtë seancës, me datë 11.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.Q nga Rahoveci.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit M.Q, në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë, për periudhën kohore nga data 21.06.2021, e deri me datën 21.11.2022, për 20 % të pagës bazë (421.00 euro) x 20 % = 84.20 euro x 17 muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,431.40 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 21.06.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit M.Q, t'i paguajë shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi M.Q, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 21.06.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për shkak të kompensimit të përqindjes në pagë, vlera e kontestit 1,431.40 euro.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura, ku i njëjti ka punuar nga data 01.09.2021 e deri me datën 21.11.2022, ndërsa nuk i është llogaritur në pagë dhe nuk është paguar diferenca në pagë prej 20% mbi pagën e rregullt. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës më dt. 11.11.2024, ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetim se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje kontestimore. Padia është e pathemeltë dhe e pabazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit - DKA. Në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, të gjitha kërkesat në para nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh. Paditësi, sipas shkresave të bashkëngjitura në padi, nuk ka argumentuar me asnjë provë se ka parashtruar kërkesë para DKA-së, në mënyrë që të fitohet baza juridike për t'iu drejtuar gjykatës për shqyrtimin e padisë nga marrëdhënia e punës, në kuptim të dispozitave të Ligjit të Punës. Nga hyrja në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit, Ministria e Arsimit si palë nënshkruese e kësaj kontrate, nuk ka ndarë mjetet financiare të nevojshme për Komunitat, respektivisht për këtu të paditurën Komuna e Rahovecit. Andaj, Komuna e Rahovecit nuk ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për zbatimin e dispozitave që kanë implikime financiare të Kontratës Kolektive të Arsimit për të punësuarit në sistemin arsimor në Kosovë, dhe se këtë obligim duhet ta merr përsipër Ministria e Arsimit, si palë nënshkruese e Kontratës Kolektive. Në kuptim të nenit 99, në lidhje me dispozitat e neneve 395.1, 395.2, 396.1, 399.1 dhe 399.2 të LPK, gjykata pas shqyrtimit të çështjes dhe administrimit të provave, mbrojtjen e të paditurës ta aprovojë si të bazuar dhe të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si dhe ti paguaj shpenzimet e procedurës.

Paditësi padisë ia kanë bashkëngjitur provat materiale si në vijim: për paditësin M.Qvërtetimi mbi muajt e punës me nr. 1482/2 e dt. 10.06.2024, për muajt 01.06.2021 deri 21.11.2022, i cili ka punuar me klasë të kombinuar i cili sot e kësaj dite vazhdon të punojë me klasë të kombinuar; Kontrata e punës me nr. Protokollin 395/2 i dt. 01.09.2015, e lidhur ndërmjet ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit, si dhe lista e pagës për paditësin.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit: M.Qpër periudhën kohore 21.06.2021 deri 21.11.2022, për 17 muaj, ku për çdo muaj nga 20 % të pagës së rregullte prej 421.00 €, t'ia paguajë shumën prej 1,431.40 €, ($421 \times 20\% = 84.20 \text{ €} \times 17 \text{ muaj} = 1,431.40 \text{ €}$).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (21.06.2024), bazuar në Mendimin Juridik për

Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Ligji i Punës Nr.03/L-212, neni 90 par.5 e përcakton se ” *Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”.

Sipas dispozitës së nenit 11 paragrafi 3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 21.01.2021, është paraparë se: “*Mësimdhënësit që punojnë me klasë të kombinuara duhet të kompensohet për 20 % mbi pagën e rregullt*”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t’ia kompensojë edhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 125,00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104,00 €, dhe në emër të taksës për padi 21,00 € bazuar në tarifën e OAK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.610/2024, më 11.12.2024

B. Profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.